



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KRYESIA

V E N D I M

Përmet, 28.02.2024

Nr. 2 datë 28.02 2024

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E
RADHËS

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17, 56, 57 dhe Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak Përmet, Kryesia e Këshillit Bashkiak Përmet, në mbledhjen e datës 28.02.2024:

V E N D O S I

- 1- Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Përmet, e cila do mbahet në datën 06.03.2024 ora 11:00.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit, në mungesë Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës të çdo këshilltar, të Kryetari i Bashkisë Përmet, Deputetët e Qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre të secili këshilltar.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Anila DHIMITRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIAPËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Prot.

Përmet, 28/02/2024

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të të Bashkisë Përmet

I nderuar këshilltar.

Ju njoftoj së ditën e Martë datë **06.03.2024** ora **11:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të të Bashkisë zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes
2. P/V: Për fillimin e procedurave për shpronësim për interes publik që preken nga nevoja për zgjerimin e sipërfaqes së varrezave publike të qytetit Përmet.
3. P/V: Për miratimin e listës së gastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë për vitet 2024-2025.
4. P/V: “Për miratimin e aktit të vlerësimit të demit të shkaktuar nga zjarri në pronën e llojit banesë të Z. Guri Mehmeti dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”.
5. P/V: “Për miratimin e aktit të vlerësimit të demit të shkaktuar nga zjarri në pronën e llojit banesë të Z. Safet Veliko dhe përdorimit të fondit për mbrojtjen civile”.
6. P/V: “Për miratimin e e aktit të vlerësimit të demit të shkaktuar nga rrëshqitja e gurëve në pronën e llojit banesë të Z. Thoma Vangjeli, dhe përdorimit të fondit për mbrojtjen civile”.
7. P/V: “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihme financiare”.
8. P/V: “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, deri ne 6% muaji Janar 2023”.
9. P/V: “Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë muaji shkurt 2024”.
10. Të tjera...

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet

Anila DHIMITRI

